

Sipas dispozitave të Rregullores së UBMIK-ut me Nr. 2001/35, mbi Pensionet në Kosovë, të datës 22 Dhjetor të viti 2001,

Me qëllim të ekzekutimit të Nenit 15.7 dhe 22.7 të Rregullores së UNMIK-ut me Nr. 2001/35 (“Rregullorja e Pensionit”), në relacion me kërkesat e Rregullës 23, të këtyre Rregullave, për parashkrimin e kërkesave që duhet të përcaktohen në kontratën e punës me revizorin e jashtëm të entitetit të pensionit,

Bordi Drejtues i Autoritetit Bankar të Pagesave të Kosovës (BPK), në mbledhjen e mbajtur më 23 tetor 2002 miraton si vijon:

Rregulla 24 që parashkruan kërkesat në letrën e angazhimit të revizorit të jashtëm të Fondit të Pensionit dhe Siguruesve të Pensionit

Neni 1

1.1 Sfera e Rregullës

Kjo Rregull i adresohet të gjitha Fondeve të Pensionit dhe Siguruesve të Pensionit dhe Revizorit të Jashtëm, të angazhuar nga këto entitete të pensionit që (të cilat) shprehin një opinion mbi kushtet financiare të entitetit të pensionit, dhe në lidhje me mjetet dhe detyrimet e rregullimit të tyre pensional.

1.2 Qëllimi i Rregullës

Kjo Rregull e plotson Rregullën 23 të këtyre Rregullave. Kjo Rregull themelon disa standarde të caktuara që të sigurojnë zhvillimin adekuat në revizionin e entiteteve të pensionit dhe të siguroj procedura uniforme dhe të qëndrueshme të kërkuara në prezentimin dhe qertifikimin e raportit financiar vjetor të Entiteteve të Pensionit.

Neni 2

Dispozitat e përgjithsme

2.1 Definimet

Në këtë Rregull, termet si vijojnë nënkuptojnë:

“Bordi i drejtorëve” nënkupton trupin drejtues të Fondit të Pensionit ose Siguruesit të Pensionit.

“Bordi” i referohet bordit të drejtorëve siq është definuar në këtë Rregull.

“Revizor i jashtëm” nënkupton individin, partneritetin, korporatën, asociacionin ose firmën, të angazhuara në biznesin e ofrimit të shërbimeve revizionues si profesion, duke poseduar shkollimin e nevojshëm, trajnimin dhe kualifikimin që të shprehin opinionin në lidhje me kushtet financiare dhe rezultatet e operimit të entitetit të pensionit dhe emrimi i të cilit është aprovuar dhe pranuar nga BPK-ja.

“Entiteti i pensionit” i referohet njerit ose të dyve, Fondit të Pensionit ose Siguruesit të Pensionit.

2.2 Kërkesat e Revizorit të jashtëm

Trupat drejtues të entitetit të pensionit duhet të parashtrojnë për një revision vjetor të revizorit të jashtëm në pajtim me këtë Rregull, për derisa nuk janë shkarkuar paraprakisht me shkrim të lëshuar nga BPK-ja.

BPK-ja, në lirinë e saj të veprimit, mundë ti jap Fondit të Pensionit një shkarkim për kërkesat e revizionit vjetor të jashtëm duke zbatua kërkesat si vijojnë:

- a) Bordi i drejtorëve të Fondit të Pensionit, me kërkesën me shkrim për shkarkim, demonstroi në BPK se kostoja e detyruar për të zhvilluar një revision të jashtëm dëmton rëndë interesin e pjesëmarrësit.
- b) Mjetet e pensionit dhe/ose vlerat prezente të benefiteve të pensioneve të tashme dhe të ardhshme të mos tejkalojnë 200,000 Euro.
- c) Numri i pjesëmarrësve të jetë 200 ose më pak.
- d) Fondi i Pensionit fajlon raportin vjetor në pajtim me kërkesat e Rregullës 23 të këtyre Rregullave dhe pastaj bordi i drejtorëve vërteton korrektsinë dhe saktësinë.
- e) Fondi i Pensionit plotson së paku kualitetin e financimit të Klasës B për skemën e pensionit me benefit të definuar ose kualitetin plotsisht të financuar për rregullimet pensionale me kontribut të definuar në pajtim me masat e përshkruara të financimit sipas Rregullës 15 të këtyre Rregullave.

Neni 3

Kriteret e kërkuara në letrën e angazhimit të Revizorit të jashtëm

3.1 Zhvillimi i revizionit dhe opinioni i revizionit

Termet, kushtet dhe qështjet e kërkuara që të jenë të përfshira në letrën e angazhimit të revizorit të jashtëm të Entitetit të Pensionit në referencë të zhvillimit të revizionit duhet të përfshijë si vijon:

- a) Shpeshtësia e revizionit. Për derisa me aprovim paraprak të shkruar të BPK-s, entitetet e pensionit duhet të kenë raportet e tyre financiare vjetore të revizionuara që të jenë konform me periodën e tyre të kontabilitetit/financiare.
- b) Emrimi i revizorit të jashtëm duhet të jetë me shkrim (“Letra e angazhimit” dhe varet prej aprovimit të BPK-s.
- c) Pavarësia e revizorit. Revizori ose firma e tij nuk ka qenë një “Entitet i Bashkuar” i entitetit të pensionit, sikur që termi është definuar në Nenin 1 të Rregullores së Pensionit.
- d) Sfera e punës së revizionit përfshinë:
1. Të shqyrtohet përshtatshmëria e revizorit dhe procedurat dhe praktikat e revizionit të brendshëm, shëno mungesat dhe bëjë rekomandim për implementim.
 2. Shpreh dhe mendimin se a prezantojnë raportet financiare pasqyrë të vërtetë dhe të drejtë të kushteve financiare dhe aktiviteteve të entitetit të pensionit në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit.
 3. Prezento një raport të revizionit dhe të dhënat në bordin e drejtorëve të entitetit të pensionit.
- e) Shkalla e përshtatshmërisë së rregullimit. Raporti i auditimit duhet të shprehë një opinion se a është entiteti i pensionit në pajtueshmëri me Rregulloren e Pensionit dhe Rregullat e Pensionit të miratuara nga BPK.
- f) Detyra e revizorit të brendshëm është që të raporton drejtë në BPK qështjet si vijojnë:
1. Akti i mashtrimit i bërë nga ndonjë nëpunës i entitetit të pensionit ose menagjerit të tij të mjeteve, kujdestarit të tij ose ndonjë prej entiteteve të bashkuara, ose ndonjë parregullsi ose mungesë në menagjmentin, adminsitrim ose operim që mundën të priten me arsye që të rezultojnë në humbje materiale të mjeteve të pensionit.
 2. Nëse entiteti i pensionit, menagjerët e tij të mjeteve, kujdestarët ose ndonjë prej entiteteve të bashkuara është në kontradiktë me Rregulloren e Pensionit ose këto Rregulla.
 3. Nëse konkluzionet e raportit të revizorit kanë qenë të përmbajtura, të injoruara ose të influencuara padrejhtësisht nga entiteti i pensionit, menagjmenti i tij ose bordi i drejtorëve, në mënyrë direkte apo indirekte.

3.2 Kërkesat për ofrimin e informatave

Përveq kërkesave që janë të parashkruara në Nën-seksionin 3.1 më lartë, qështjet që vijojnë duhet gjithashtu që të inkorporohen në letrën e angazhimit të revizorit:

- a) Pranueshmëria e angazhimit me nënshkrimin e revizorit se pajtohet me kushtet dhe termet.
- b) Përgjegjësitë e Bordit të Drejtorëve që të mbajnë BPK-n të informuar rreth punëve të biznesit të kompanisë së licensuar.
- c) E drejta e revizorit që të komunikojë në BPK qdo informatë ose opinion për qështjet që ka vënë re se janë relevante për rolin mbikqyrës të BPK-s për entitetet e pensionit, menagjerin(ve) e tij të mjeteve, kujdestarin dhe/ose Pundhënësit që sponsorojnë Fondin e Pensionit.
- d) Detyra e revizorit për të raportuar qështjet e signifkancës esenciale në BPK.
- e) Obligimet e revizorit që të sigurojnë qasje për letrat e tij të punës për qëllime rregullatore në kërkesën e BPK-s.
- f) Obligimet e revizorit për të dhënë informata për ngjarjet e njëpasnjëshme që janë thelbsore , ose të pritura me arsye që esencialisht të ndikojnë në kushtet financiare të Entitetit të Pensionit dhe/ose prej ktu edhe opinionin e revizorit.
- g) Detyra e revizorit që të paraqes ndonjë transaksion që involvon një entitet të bashkuar të Entitetit të Pensionit dhe qështje të tilla që mundë të kërkohen nga BPK-ja në pajtueshmëri me standardet e përgjithshme të dhënjes së informatave të aplikueshme për Entitetin e Pensionit.
- h) Të gjitha ofrimet e informatave të tjera që do ti kërkojë BPK-ja, kohë pas kohe.

Neni 3 Hyrja në fuqi

Kjo rregull do të hyj në fuqi më 23 tetor 2002.

Drejtori i Përgjithshëm

